

INSTITUTI I STUDIMEVE PEDAGOGJIKE

PROGRAMI I LËNDËS

SË GJUHËS SHQIPE

KLASA II

CIKLI FILLOR I SHKOLLËS 9-VJEÇARE

TIRANË, 2004

1. HYRJJE E PËRGJITHSHME PËR LËNDËN (KLASA 1-9)

Mësimi i gjuhës amtare në shkollë ka rëndësi të veçantë. Përmes tij krijohen dhe transmetohen nocionet dhe mesazhet, të cilat janë çelësat për kuptimin e vetvetes dhe të botës. Gjuha amtare është mjeti më i rëndësishëm për realizimin e kuptimit dhe të bashkëpunimit.

Saktësia, frytshmëria, si dhe arritja e tyre varen drejtpërdrejt nga mundësitë dhe njohuritë për gjuhën. Kjo nuk vlen vetëm për gjuhën shqipe si lëndë mësimore, por për çdo lëndë tjetër mësimore, e cila duhet të jetë e formuluar në mënyrë të përpiktë dhe të qartë gjuhësore, në fushën e vet, si bashkëpërgjegjëse për formimin gjuhësor të nxënësit, duke siguruar në këtë mënyrë cilësinë e dijeve sipas lëndëve.

Mësimi i gjuhës shqipe shtrihet përtej lëndës. Natyrisht, detyrë themelore e saj është zhvillimi i kujdesshëm dhe i vazhdueshëm si gjuhë vetjake dhe e përdorur si gjuhë amtare në nivelin e vet më të mirë, në formën e vet standarde.

Drejtimi i mësipërm për mësimin e gjuhës shqipe si lëndë mësimore realizohet përmes përvetësimit të katër shprehive (komunikative) të kuptueshmërisë – të *dëgjuarit*, të *folurit*, të *lexuarit* dhe të *shkruarit*.

2. SYNIMI I LËNDËS

Qëllimi i mëimit të gjuhës shqipe është përvetësimi me më nivel e më mirë i të katër shprehive komunikuese gjuhësore: të dëgjuarit, të folurit, të lexuarit, të shkruarit, si dhe i njohurive themelore të sistemit të gjuhës, kuptimi dhe interpretimi i teksteve letrare dhe joletrare etj., të lidhura ngushtë me aftësimin dhe formimin gjuhësor, kulturor, etik, shpirtëror të brezit të ri, si domosdoshmëri për të ardhmen e kombit tonë.

Ky kuptim për qëllimin e lëndës përshtatet për faza të ndryshme të zhvillimit gjuhësor shpirtëror dhe psikik, në nivele të ndryshme të zhvillimit të nxënësve.

Kështu, lënda e gjuhës shqipe në nëntëvjeçarin e parë përfshin rreth 1 960 orë mësimore të shpërndara si më poshtë:

Klasa 1-5	Javë/ Orë	Klasa 6-9	Javë/ O rë
Klasa e parë	35 javë x 8 orë = 280 orë	Klasa e gjashtë	35 javë x 5orë = 175 orë
Klasa e dytë	35 javë x 8 orë = 280 orë	Klasa e shtatë	35 javë x 5orë = 175 orë
Klasa e tretë	35 javë x 7 orë = 245 orë	Klasa e tetë	35 javë x 5orë = 175orë
Klasa e katërt	35 javë x 7 orë = 245 orë	Klasa e nëntë	35 javë x 5orë = 175 orë
Klasa e pestë	35 javë x 6 orë = 210 orë		

Me hyrjen në botën e leximit dhe të shkrimit, nxënësit:

- **Kryejnë** aktivitete të shumta e të larmishme, bashkëpunojnë në biseda, veprimtari etj.
- **Zhvillojnë** mundësinë e të menduarit logjik dhe mundësinë e konceptimit, të drejtshqiptimit dhe të drejtshkrimit.
- **Interpretojnë** dhe **krijojnë** tekste artistike.
- **Krijojnë** (flasin dhe shkruajnë), **pranojnë** (dëgjojnë dhe lexojnë) dhe **zërthejnë** sipas aftësive, përvojave, moshës dhe interesimit të tyre tekste të ndryshme artistike dhe joartistike.
- **Zhvillojnë** aktivisht mundësitë e tyre të njohjes, të të kuptuarit dhe prirjet krijuese, si dhe i vendosin ndryshimet themelore në pranimin, krijimin dhe ndërtimin e teksteve letrare dhe joletrare.
- **Vendosin** raporte të përshtatshme pune me tekstin letrar dhe joletrar.

3. QËLLIMET THEMELORE TË LËNDËS

1. Nxënësit të *krijojnë* marrëdhënie pozitive, emocionale dhe psikike ndaj gjuhës shqipe; fillojnë të kuptojnë se gjuha shqipe, si gjuha e tyre amtare, është cilësia më e lartë natyrore socializuese, sepse nëpërmjet saj, lehtësisht dhe në mënyrë të suksesshme shprehen, përfitojnë marrëdhënie pozitive ndaj letërsisë shqipe, qartësohen se leximi i teksteve për ta ka domethënien e takimit me modelet e përvojës e të kulturës kombëtare.
2. Nxënësit të *kuptojnë* se gjuha shqipe është gjuha shtetërore në Republikën e Shqipërisë; të *formojnë* vetëdijen kombëtare dhe shtetërore dhe, krahas saj, edhe nderimin dhe tolerancën ndaj gjuhëve dhe kombeve tjera.
3. Nxënësit gradualisht dhe në mënyrë të planifikuar të *përvetësojnë* dhe të *përdorin* krahas të folmes lokale (dialekteve/ gjuhës së folur të krahinës) edhe gjuhën letrare (të folur dhe të njësuar); të përfitojnë vetëdijen mbi përdorimin e gjuhës letrare dhe joletrare në situata të ndryshme të të folurit.
4. Nxënësit të ushtrohen në të katër aktivitetet e kuptimshmërisë (*të dëgjuarit, të folurit, të lexuarit e të shkruarit*), pasi këto aktivitete u mundësojnë njohjen e vetes dhe të botës përreth, duke plotësuar nevojat themelore, shpirtërore dhe shoqërore. Përvetësimi i këtyre përvojave dhe aktiviteteve shton mundësitë e funksionimit të tyre në rrethin e vet, si dhe njohjen dhe shprehjen e botës materiale, shpirtërore dhe imagjinare.
5. Nxënësit të zhvillojnë përgatitjen për të folurit, të përfitojnë vetëbesim për shprehjen e mendimeve, të ndjenjave, kërkesave, dëshirave dhe krijimit. Me aktivitetin e të folurit të zgjidhin në mënyrë paqësore e të drejtë tensionet dhe konfliktet në situata të ndryshme jetësore. Me këtë, ata do të përforcojnë vetëdijen dhe mundësinë e respektimit të mendimit ndryshe.
6. Nxënësit në mënyrë spontane, nëpërmes lojës, e më vonë, edhe në mënyrë të udhëhequr dhe sistematike, të hyjnë në leximin dhe shkrimin e pavarur. Me aktivitete individuale të zbulojnë dhe të provojnë gjuhën e shkruar për kuptim, mendim, krijim, mësim dhe argëtim; të zhvillojnë proceset e krijimit, të

domethënies dhe të përdorimit të drejtë të sistemeve standarde të paraqitjes së saj me shkrim.

7. Nxënësit të pranojnë (të dëgjojnë, lexojnë) tekste të ndryshme letrare dhe joletrare, që janë të prezentuara në mënyrë direkte apo indirekte (nga media); nga teksti të nxjerrin vlerat themelore (p.sh: e saktë/ e pasaktë, e drejtë/ jo e drejtë, e ndershme/ e pandershme) në mënyrë që të mësohen t'i vlerësojnë tekstet e veta dhe të tjerëve.
8. Nxënësit të përfitojnë marrëdhënie pozitive psikike dhe logjike ndaj gjuhës shqipe; të kuptojnë se shqipja si gjuha e tyre amtare është e dhëna më e mirë natyrore socializuese; të përfitojnë marrëdhënie pozitive edhe ndaj letërsisë dhe të zhvillojnë kulturën e leximit përmes leximit të letërsisë shqipe dhe asaj të huaj. Nxënësit të zgjerojnë horizontin dhe të bëhen tolerantë ndaj kulturave të tjera.
9. Nxënësit të kuptojnë se gjuha shqipe është gjuha shtetërore, të kuptojnë, gjithashtu, pozitën specifike e të formojnë vetëdijen kombëtare dhe shtetërore, e pranë kësaj edhe ndjenjën e respektimit dhe të tolerancës ndaj gjuhës dhe kombeve tjera.
10. Nxënësit të përforcojnë dijet e tyre mbi gjuhën letrare (të folur dhe të shkruar), të begatojnë vetëdijen për rrethana të ndryshme, për përdorimin e gjuhës letrare dhe joletrare në situata të ndryshme të të folurit, duke u përpjekur të flasin në gjuhë standarde.
11. Nxënësit të jenë të motivuar për të katër shprehjet komunikative të kuptimësisë (*të dëgjuarit, të folurit, të shkruarit dhe të lexuarit*); të dëgjojnë dhe të lexojnë tekste artistike dhe joartistike të përshtatshme për moshën e tyre; të kuptojnë se kjo u hap mundësi të reja për plotësimin e kureshtjes dhe të nevojave themelore shpirtërore dhe shoqërore, për njohjen e botës materiale, shpirtërore dhe të ëndrrave, për kuptimin e vetvetes, të botës përreth si dhe për argëtim; të zhvillojnë aftësitë e të folurit dhe të të shkruarit për të shprehur *mendimet, qëndrimet, kërkesat, ndjenjat dhe përvojat* e tyre, si dhe të zgjidhin në mënyrë paqësore problemet e veta; të jenë të vetëdijshëm se të folurit e të shkruarit janë aktivitete ndërnjerëzore, gjatë të cilave duhet nderuar bashkëbiseduesi dhe duhet kuptuar pozita e folësit.
12. Nxënësit të dëgjojnë e të lexojnë në mënyrë racionale dhe kritike tekstet joartistike; t'i pranojnë të dhënat qenësore dhe të gjejnë të dhënat e dëshiruara (për t'i përdorur në jetën e përditshme); të nxjerrin vlerat themelore, duke i vlerësuar tekstet, të përpiqen të argumentojnë; të kuptojnë si ndikon reklama si material propagandistik; të dallojnë përshkrimin real nga ai i reklamës.
13. Nxënësit të ruajnë dhe të zhvillojnë interesin për dëgjimin dhe leximin e teksteve artistike (të dëgjojnë rrëfimin e mësuesit dhe të lexojnë individualisht). Takimi me letërsinë të jetë burim i kënaqësisë letrare – estetike; të zhvillojnë interesimin për përcjelljen e poezisë, të prozës dhe dramatikës, si dhe për interesat e veçanta letrare, p.sh: të zhanreve dhe tematikave); të lexojnë dhe vlerësojnë letërsinë; të shfaqin dëshirë për të ndjekur filma artistikë dhe filma vizatimorë; të dallojnë filmin vizatimor nga filmi artistik dhe ai dokumentar.

PROGRAMI I LËNDËS

Gjuhë shqipe

Klasa II

35 javë x 8 orë = 280orë

1. HYRJE

Mësimi i gjuhës shqipe në moshën të ulët shkollor ka si synim krijimin e vetëdijes mbi rëndësinë e saj dhe përvetësimin gradual të njohurive dhe koncepteve gjuhësore.

Mbi këtë kuptim, është ndërtuar edhe programi i lëndës së gjuhës shqipe në klasën e dytë. Ai mbështetet në katër kategoritë bazë komunikuese: *të dëgjuarit, të folurit, të lexuarit e të shkruarit* dhe nënkategorivetë që rrjedhin prej tyre, si: *kultura e të dëgjuarit, kultura e të folurit, kultura e të lexuarit, kultura e të shkruarit, tekstet letrare dhe joletrare, si dhe njohuritë gjuhësore.*

Përmes këtyre drejtimeve realizohet përmbajtja e programit në përputhje me moshën e nxënësve. Përvetësimi i njohurive themelore për sistemin e gjuhës për tekstet letrare dhe joletrare, formimi kulturor, komunikimi, toleranca, argumentimi, mendimi kritik etj., janë kërkesa të rëndësishme të këtij programi që ndikojnë dhe mundësojnë rritjen dhe zhvillimin e përgjithshëm e individual të nxënësve.

2. SYNIMET

Mësimi i gjuhës shqipe në klasën e dytë synon **ta aftësojë nxënësin të përdorë saktë gjuhën amtare, të hyjë në komunikim me të tjerët, duke transmetuar mendime nëpërmjet të folurit, të lexuarit dhe të shkruarit, duke fituar dhe pasqyruar përvoja gjuhësore të larmishme, nëpërmjet të cilave pasqyrohen imagjinata dhe ndjenjat rreth dukurive të jetës dhe të botës që e rrethon, duke shprehur aftësi dhe qëndrime për zhvillimin e tij gjuhësor dhe intelektual.**

Nëpërmjet mësimi të gjuhës shqipe në klasën e dytë nxënësi arrin:

- Të përvetësojë dhe të zgjerojë mënyrat e komunikimit.
- Të kuptojë dhe të dallojë tekstet letrare nga ato joletrare.
- Të përvetësojë dhe të thellojë njohuritë themelore gjuhësore.

3. FUSHAT DHE NËNFUSHAT E STUDIMIT

Fushat e studimit të gjuhës shqipe janë:

- **Të dëgjuarit**
- **Të folurit**
- **Të lexuarit**
- **Të shkruarit**

Nënfushat e studimit janë:

Nr.	Të dëgjuarit & Të folurit	Të lexuarit	Të shkruarit	Njohuri rreth gjuhës
1	Të dëgjuarit e të folurit për të marrë e dhënë informacion, udhëzime dhe orientime	Të lexuarit për të marrë informacion	Të shkruarit funksional	Morfosintaksë: ▪ Sintaksë ▪ Morfologji ▪ Fjalëformin
2	Të dëgjuarit dhe të folurit në grup	Të lexuarit për të kuptuar pjesën e për të njohur idetë e shkrimtarit	Të shkruarit personal	Kulturë gjuhësore
3	Të dëgjuarit dhe të folurit për të paraqitur përvoja dhe ndjenja vetjake	Të lexuarit për dëshirë e për zhvillimin e ndjenjave	Të shkruarit me ndjenjë dhe imagjinatë	Leksiokologji
4	Të dëgjuarit dhe të folurit rreth llojeve dhe gjinive letrare	Të lexuarit e llojeve dhe gjinive të ndryshme letrare	Të shkruarit me modele të ndryshme të të shkruarit	Drejtskrim
5	Të dëgjuarit dhe të folurit për të paraqitur njohuri rreth gjuhës	Të lexuarit me zë të lartë, sipas teknikës së recitimit	Të shkruarit duke respektuar shenjat e pikësimit	Pikësim

4. OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM

Lënda e gjuhës shqipe në klasën e dytë synon:

- Ta aftësojë nxënësin si përdorues të mirë i gjuhës amtare përmes kërkimit, shkëmbimit të ideve dhe informacioneve: *të tregojë, të raportojë, të argumentojë e të zhvillojë* ndjenjën e identitetit të tij kombëtar.
- Të zhvillojë mendimin e pavarur të nxënësit, duke e nxitur atë për të *ngritur hipoteza, për të zbuluar ide, për të reflektuar, klasifikuar, krahasuar dhe vlerësuar rreth tyre.*
- Të aftësojë nxënësin për shprehur ndjenjat nëpërmjet *të folurit, të lexuarit dhe të shkruarit.*
- Të aftësojë nxënësin për të reflektuar ndaj vlerave personale dhe të shokëve, në marrjen e vendimeve, në zgjidhjen e konflikteve etj.
- Të aftësojë nxënësin për ta shkruar gjuhën në modele të thjeshta në përshtatje me natyrën dhe moshën e tij, të cilat kanë të bëjnë me shkrimin e letrave të thjeshta (këshilla, njoftime), të ngjarjeve të shkurtra, të përshkrimeve etj.

4. STRUKTURA SINTETIKE E PROGRAMIT

Linja		Orë	Nënlinjat	Orë
1.	GJUHË E FOLUR	30	▪ Gjuhë e folur	30
2.	LEXIM	120	▪ Prozë e poezi	120
			▪ Përralla	
			▪ Tregime	
			▪ Vjersha	
			▪ Gjëegjëza	
			▪ Lexime jashtë klase	
3.	GJUHË E SHKRUAR	30	Gjuhë e shkruar	30
4.	NJOHURI RRETH GJUHËS	82	▪ Sintaksë	24
			▪ Morfologji	32
			▪ Leksikologji	6
			▪ Drejtshkrim-pikësim	20
5.	DISPOZICION	18	▪ Dikttime	18
			▪ Përsëritje	
			▪ Testime	

OBJEKTIVAT SPECIFIKË

Në përfundim të klasës së dytë, nxënësi duhet të fitojnë shprehitë e mëposhtme komunikative:

Nr.	Të dëgjuarit	Të folurit	Të lexuarit	Të shkruarit	Njohuri rreth gjuhës
1	Të dëgjojë me vëmendje të tjerët.	Të marrë pjesë në bashkëbisedim.	Të lexojë për të marrë informacion.	Të shkruajë një informacion që i kërkohet.	Sintaksë <ul style="list-style-type: none"> Të njohë tekstin dhe këto lloje fjalish: e thjeshtë (dëftore dhe pyetëse), pohore dhe mohore.
2	Të kuptojë atë që sheh dhe dëgjon.	T'u përgjigjet pyetjeve që i bëhen.	Të lexojë për të kuptuar materialin.	Të shkruajë me një gjuhë të thjeshtë dhe me kuptim.	Morfologji <ul style="list-style-type: none"> Të njohë fjalët sipas klasave leksiko-gramatikore: <i>emër, mbiemër, folje</i>. Të njohë kategoritë kryesore leksiko-gramatikore të <i>emrit e të mbiemrit</i> (gjininë e numrin) dhe <i>të foljes</i> (kohën, vetën). Të njohë kohën e tashme e të ardhme të foljes.
3	Të marrë pjesë në bashkëbisedim.	Të shprehë mendime, ndjenja dhe përvoja personale.	Të zhvillojë e të pasurojë dëshira e ndjenja.	Të shkruajë me ndjenjë dhe imagjinatë.	
4	Të përqendrohet në çështjet kryesore që diskutohen.	Të mendohet para se flasë.	Të kuptojë idetë, mendimet dhe ndjenjat e shkrimtarit.	Të shkruajë në mënyrë funksionale për qëllime të caktuara.	
5	Të ndjekë bashkëbiseduesin për të pasur mundësi t'i përgjigjet atij.	T'u përgjigjet pyetjeve që i bëhen nga bashkëbiseduesi.	Të shprehë mendimin personal rreth veprës së lexuar.	Të shkruajë pyetje dhe t'u përgjigjet me shkrim pyetjeve që i drejtohen.	Drejtshkrim <ul style="list-style-type: none"> Të përdorë drejt shkronjën e madhe.

6	Të marrë informacion e ta përdorë kur i nevojitet.	Të japë informacionin e nevojshëm në momentin e duhur.	Të pasurojë fjalorin me fjalë dhe shprehje të fushave të ndryshme tematike.	Të modelojë shkrime të thjeshta të tipit: <i>letër, kartolinë përshkrim, udhëzim, këshillë.</i>	<ul style="list-style-type: none"> Të përdorë drejt shenjat e pikësimit: <i>pikën, pikëpyetjen dhe pikëçuditësen.</i>
7	Të dëgjojë krijime në gjini e lloje të ndryshme letrare, si: <i>përralla, tregimi, vjersha e gjëgjëzat.</i>	Të shprehet në gjini e lloje të ndryshme letrare.	Të njohë gjini dhe lloje letrare të tilla, si: <i>përralla, tregimi, vjersha e gjëgjëza.</i>	Të shkruajë histori të thjeshta në gjini e lloje të ndryshme.	<ul style="list-style-type: none"> Të shkruajë saktë emra të gjinisë femërore dhe mashkullore në numrin njëjës dhe shumës.
8	Të respektojë interpretime të ndryshme ndaj llojeve e gjinive letrare.	Të përpunojë mendimin para se ta shfaqë.	Të njohë me gjuhën dhe veçoritë e veprave letrare.	Ta ndërtojë saktë tregimin, duke u orientuar nga pyetjet, fjalët e figurat ndihmëse, si dhe nga struktura gjysmë të gatshme.	<ul style="list-style-type: none"> Të shkruajë saktë mbiemra të gjinisë femërore e mashkullore në numrin njëjës dhe shumës.

ZBËRTHIMI I PROGRAMIT SIPAS LINJAVE DHE NËNLINJAVE

LINJA: TË DËGJUARIT E TË FOLURIT (30 ORË)

Nënlinjat	Tematika	Objektivat	Arritjet e pritshme
1. Të dëgjuarit e të folurit për të marrë informacion, udhëzime dhe orientime	☞ Tema nga jeta reale dhe veprimtaritë e përditshme: <i>mësimi, loja, ëndrrat, familja, shkolla, shoqëria</i>	<ul style="list-style-type: none"> • Të përgjigjet në përshtatje me atë që i kërkohet. • Të këshillojë dhe të japë informacione e mesazhe të shkurtra. • Të ndjekë radhën ose hapat e veprimeve që do të kryhen. • Të japë udhëzime e orientime me fjalë të thjeshta. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dhënie e përgjigjeve të shkurtra, të plota e të sakta për pyetjet që i drejtohen. ▪ Dhënia saktë e informacioneve e udhëzimeve të thjeshta, pa ngatërruar radhën e veprimeve. ▪ Dëgjimi dhe të pyeturit për gjëra që i interesojnë.
2. Të dëgjuarit dhe të folurit në grup	☞ Tema që lidhen me çështjet shoqërore që u përkasin dhe marrëdhëniet ndërmjet njerëzve	<ul style="list-style-type: none"> • Të dëgjojë dhe të flasë duke respektuar rregullat e të folurit në grup. • Të diskutojë në grup për çështje të caktuara. • Të luajë role të thjeshta. • Të respektojë e të vlerësojë mendimet dhe idetë e shokëve. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dëgjim i vëmendshëm i bashkëbiseduesit dhe marrja e fjalës atëherë kur i jepet. ▪ Shfaqje e mendimit dhe e ndjenjave personale rreth çështjeve që diskutohen. ▪ Interpretim i mirë i rolit në grupe të vogla dhe të mëdha. ▪ Vlerësimi i mendimit të shokut në çift dhe në grup.
3. Të dëgjuarit dhe të folurit rreth teksteve të ndryshme	☞ Tema sipas gjinive e llojeve të ndryshme letrare për të cilat kanë interes fëmijët	<ul style="list-style-type: none"> • Të dëgjojë dhe të flasë për tekste të ndryshme që janë në përshtatje me moshën e tij, që kanë strukturë dhe gjuhë të gjetur. • T'u përgjigjet pyetjeve rreth përmbajtjes së teksteve dhe figurave që shikojnë. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dëgjim i vëmendshëm dhe shprehje e mendimeve rreth teksteve të lexuara. ▪ Shprehje e pëlqimit ose jo për pjesët e dëgjuara apo të lexuara. ▪ Drejtim pyetjesh për detaje të ndryshme të përmbajtjes, personazhet etj., të pjesëve të dëgjuara apo të lexuara.

4. Të dëgjuarit dhe të folurit e llojeve dhe gjinive letrare	☞ Tema të larmishme që trajtohen në lloje e gjini të veçanta letrare, si: <i>vjersha, përralla, tregimi dhe gjëegjëza</i> .	<ul style="list-style-type: none"> • Të njohë këto lloje dhe gjini letrare: vjershën, përrallën, tregimin dhe gjëegjëzën. • Të dallojë intonacionin e zërit në një vjershë, përrallë dhe tregim. • Të gjejë hyrje dhe mbyllje të reja në një përrallë ose tregim. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Njohje dhe dallim i llojeve dhe gjinive nga njëra-tjetra: i përrallës nga tregimi, vjersha e gjëegjëza. ▪ Dallim i llojit të pjesës që lexon apo dëgjon, nisur nga intonacioni dhe fjalët specifike të përdorura në të. ▪ Gjetje hyrjesh dhe mbylljesh të reja në pjesët që dëgjon dhe lexon.
5. Njohuri rreth gjuhës standarde shqipe	☞ Tema të ndryshme që përmbajnë fjalë, shprehje dhe terma nga fusha të ndryshme tematike	<ul style="list-style-type: none"> • Të shqiptojë saktë tingujt dhe fjalët. • Të njohë kuptimin e parë të fjalëve më të përdorshme. • Të pasurojnë fjalorin me fjalë e shprehje specifike, në përshtatje me fushat tematike. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Njohje e kuptimit të fjalëve e shprehjeve të reja. ▪ Përdorim i termave specifike, si: <i>përrallë, tregim, vjershë, titull, varg, rresht, hyrje e mbyllje</i>.

LINJA: TË LEXUARIT*(120 ORË)

* Udhëzohet që të zgjidhen pjesë përfaqësuese nga letërsia shqipe dhe e huaj në përshtatje me moshën e fëmijëve të klasës së dytë, të cilat të plotësojnë kriteret didaktike të gjatësisë, të strukturës dhe qartësisë së gjuhës.

Të përfaqësohen pjesë nga tradita, nga e kaluara, e sotmja dhe e ardhmja përmes raporteve të drejta, ku vendin kryesor ta zënë pjesë që pasqyrojnë të sotmen dhe pjesë që zhvillojnë imagjinatën për jetën në të ardhmen.

Këto raporte të përfaqësohen sipas ndarjeve të mëposhtme.

- 30% pjesë me përmbajtje nga e kaluara.
- 40% pjesë me përmbajtje nga e sotmja dhe veprimtaria jetësore; aventurat dhe “bëmat” e fëmijëve sot, të drejtat e fëmijëve etj.
- 30% pjesë që zhvillojnë fantazinë dhe imagjinatën për të ardhmen në fusha të ndryshme të veprimtarisë jetësore të fëmijëve: *kozmos, shkencë, informacion, mjedis etj.*

Përsa i përket përfaqësimit të teksteve letrare, me tekstet joletrare të respektohen raportet 80 me 20%.

Nënlinja	Tematika	Objektivat	Arritjet e pritshme
1. Të lexuarit për të kuptuar pjesën e për të marrë informacion	☞ Tekste letrare dhe jo letrare që japin informacione, udhëzime e orientime nga fusha të ndryshme.	<ul style="list-style-type: none"> • Të lexojë në mënyrë të tillë që të kuptojë pjesën. • Të bëjë pyetje pasi të ketë lexuar tekstin për detaje të informacionit apo të udhëzimit, për të pasuruar më tej informacionin rreth tyre etj. • Të zgjerojë me detaje shtesë informacionin e marrë nga burime të ndryshme, si: libri, TV, Video, Interneti etj. • Të japë udhëzime të thjeshta. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Lexim me shpejtësinë e duhur ▪ Të kuptuarit e përmbajtjes dhe marrja e informacionit që ajo përfshin. ▪ Drejtim pyetjesh për marrje të të dhënave shtesë. ▪ Formulim udhëzimesh për tema për të cilat është lexuar më parë.
2. Të lexuarit për dëshirë dhe për zhvillimin e ndjenjave	<p>☞ Pjesë që u ngjallin nxënësve emocione, dëshirë për t'i lexuar deri në fund dhe u zhvillojnë ndjenja pozitive me tema nga: <i>loja, fitorja, humbja, dashuria, bashkëpunimi,, besa, ndihma, ndershmëria etj.</i></p> <p>☞ Pjesë ku nxënësit nxënësit gjejnë miqtë e tyre të tregimeve dhe përrallave.</p> <p>☞ Tekste që përmbajnë fabul interesante, të cilat i nxisin nxënësit të tregojnë histori të ngjashme interesante, ëndrra etj.</p>	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Të lexojë me interes, emocion, dëshirë dhe me ndjenjë. ▪ Të tregojë se cilët janë personazhet e preferuar, duke e mbështetur mendimin me argumente. ▪ Të bashkëbisedojë me personazhet e dashura për ëndrra të përbashkëta. ▪ Të krijojë lidhje ndërmjet filmave, figurave dhe historive të lexuara. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Motivim për të lexuar. ▪ Lexim i pjesëve me dëshirë, emocion dhe kënaqësi. ▪ Gjetje e pikave të përbashkëta me personazhet e pjesëve që lexojnë. ▪ Përshkrim, rrëfim apo tregim me ndjenjë dhe emocion i pjesëve që lexon. ▪ Zhvillim i të menduarit dhe i ndjenjave të nxënësve.
3. Të lexuarit për të reflektuar mbi idetë e pjesës	☞ Tekste letrare dhe jo letrare të mbushura me të dhëna e detaje kryesore, që i nxjerrin qartë idetë dhe mesazhin e pjesës.	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Të kuptojë brendinë e pjesës që lexon. ▪ Të nxjerrë pikat e planit dhe mesazhin e pjesës që lexon. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Nxjerrje e ideve kryesore dhe mesazhit të pjesës së lexuar. ▪ Drejtim pyetjesh për detaje dhe ide që i interesojnë gjatë dhe pas

	<ul style="list-style-type: none"> ☞ Tekste që përmbajnë përshkrime të mjediseve dhe njerëzve që marrin pjesë në to. ☞ Teskte që i nxisin nxënësit t'i reflektojnë idetë në mënyra të ndryshme: me anë të vizatimeve, diagrameve, shkrimeve, poezive etj. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Të ritregojë me fjalë të thjeshta përmbajtjen e pjesës së lexuar. ▪ Të japë mendimin personal nëse tema e pjesës që lexon ka lidhje me botën dhe interesat e tij. ▪ Të analizojë personazhin kryesor. 	<p>leximit të pjesës.</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Ritregim i përmbajtjes duke u mbështetur në momentet kryesore të saj. ▪ Shprehje e mendimit nëse pjesët lidhen me interesat dhe botën e tyre ose jo.
4. Të lexuarit e llojeve dhe gjinive letrare	<ul style="list-style-type: none"> ☞ Pjesë të llojëve dhe gjinive të ndryshme letrare, si: <i>përralla, tregimi, vjersha dhe gjëegjëza</i>. ☞ Pjesë në të cilat dallohen tipare të llojeve e gjinive të ndryshme që nga mënyra e organizimit të faqes, të përzgjedhjes së figurave, gjuhës, titullit etj. 	<ul style="list-style-type: none"> • Të lexojë pjesë që u përkasin llojeve dhe gjinive të ndryshme letrare. • Të dallojë elemente të stilit dhe të gjuhës të tilla, si: <i>paragrafi, rreshti, strofa, vargu</i>. • Të dallojë vjershën nga tregimi, përralla dhe gjëegjëza. • Të shprehë pëlqimin ose mospëlqimin për lloje e gjini të veçanta. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Gjetje e llojit dhe e gjinisë që u përkasin pjesëve të lexuara. ▪ Dallim i elementeve të stilit dhe të gjuhës të tilla, si: <i>paragrafi, rreshti, strofa, vargu</i>. ▪ Dallim i vjershës nga tregimi, përralla dhe gjëegjëza. ▪ Përcaktim i llojit dhe gjinisë së preferuar.
5. Të lexuarit me zë të lartë dhe në heshtje	<ul style="list-style-type: none"> ☞ Pjesë që duke u lexuar me zë të lartë ngjallin emocion te dëgjuesit. ☞ Pjesë të transmetuara në radio e televizion që duhen imituar nga nxënësit (tempi, ritmi, theksi). 	<ul style="list-style-type: none"> • Të lexojë me zë të lartë me intonacionin e duhur. • Të recitojë bukur, qartë e më zë të lartë vjershat. • Të imitojë zërin e një personazhi të tregimit dhe të përrallës së lexuar. • Të imitojë zërin e një personi që flet në një transmetim (sigël, reklamë, batutë, film etj.). • Të luajë në rol personazhin e preferuar. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Lexim pjesësh me zë të lartë apo në heshtje, në varësi të llojit të saj. ▪ Recitim përmendësh i vjershave të shkurtra. ▪ Imitim personazhesh të dashura, ose personash që interpretojnë gjëra të ndryshme. ▪ Interpretim i rolit të një personazhi.

<p>6. Njohuri rreth gjuhës standarde shqipe</p>	<p>☞ Pjesë dhe tekste që i familjarizojnë nxënësit me terma të tilla, si: <i>autor, titull, faqe vjershë, strofë, varg, tregim, përrallë, paragraf, rresht, teatër, rol, figurë, gjëegjëzë, përgjigje, personazh, hyrje, mbyllje, ide, mesazh.</i></p>	<ul style="list-style-type: none"> • Të njohë e të dallojë terma të tilla, si: <i>autor, titull, faqe vjershë, strofë, varg, tregim, përrallë, paragraf, rresht, teatër, rol, figurë, gjëegjëzë, përgjigje, personazh, hyrje, mbyllje, ide, mesazh</i> në pjesët që lexon. • Të respektojë gjatë të lexuarit shenjat e pikësimit: pikën, pikëpyetjen dhe pikëçuditësen. • Të kuptojë të gjitha fjalët e teksteve që lexon. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Njohje dhe përdorin i termave specifike, si: <i>autor, titull, faqe vjershë, strofë, varg, tregim, përrallë, paragraf, rresht, teatër, rol, figurë, gjëegjëzë, përgjigje, personazh, hyrje, mbyllje, ide, mesazh</i> në pjesët që lexon. ▪ Lexim me intonacion dhe duke respektuar shenjat e pikësimit. ▪ Njohje e kuptimit të aprë të fjalëve të reja që ndesh në një tekst.
---	--	---	---

LINJA: TË SHKRUARIT (30 ORË)

Nënlinja	Tematika	Objektivat	Arritjet e pritshme
<p>1. Të shkruarit funksional</p>	<p>☞ Modele shkrimesh me karakter funksional të tilla, si: njoftime, udhëzime orientime dhe porosi të thjeshta.</p> <p>☞ Fragmente shkrimesh nga revistat dhe gazetat për fëmijë që përmbajnë shkrime të karakterit funksional.</p> <p>☞ Modele gjysmë të gatshme në të cilat nxënësit do të plotësojnë fjalët dhe shprehjet që mungojnë.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Të kopjojë saktë, qartë e kuptueshëm udhëzime, njoftime, orientime e porosi të thjeshta. • Të shkruajë këshilla e porosi të thjeshta për të tjerët. • Të mbajë shënime të shkurtra për udhëzime, porosi e njoftime që i interesojnë. • Të plotësojë saktë modelet gjysmë të gatshme duke u ndihmuar nga fjalë apo pyetje ndihmëse. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Kopjim i saktë i udhëzimeve, njoftimeve, orientimeve dhe porosive të thjeshta. ▪ Mbajtja e shënimeve të thjeshta e të shkurtra për gjëra që i interesojnë. ▪ Shkrim i një njoftimi, udhëzimi dhe porosie sipas të gjitha rregullave të shkrimit.
<p>2. Të shkruarit</p>	<p>☞ Modele letrash të thjeshta.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Të kopjojë saktë modele urimesh 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Shkrim i një urimi, kartoline e

<p>personal (për nevoja vetjake)</p>	<ul style="list-style-type: none"> ☞ Modele urimesh e kartolinash të dërguara në raste të ndryshme. ☞ Histori dhe përvoja personale të fëmijëve të kësaj moshe. ☞ Modele ditaresh e planesh të thjeshta të bashkëmoshatarëve. 	<p>kartolinash e letrash.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të shkruajë vetë një urim, kartolinë dhe një letër të thjeshtë. • Të shkruajë në ditar gjërat që i bëjnë më tepër përshtypje nga jeta e përditshme. • Të përshkruajë histori e përvoja personale i ndihmuar nga pyetjet: <i>Kush? Cili? Çfarë? Si? Me kë? Kur? Ku?</i> etj. • Të hartojë një plan të thjeshtë të regjimit ditor. 	<p>letre të thjeshtë në mënyrë të pavarur.</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Mbajtje ditari nga nxënësit e interesuar. ▪ Përshkrim i shkurtër, por me dateje i historive personale. ▪ Hartimi i planit ditor nga të gjithë nxënësit.
<p>3. Të shkruarit me ndjenjë dhe imagjinatë</p>	<ul style="list-style-type: none"> ☞ Tekste me portrete njerëzish dhe pamje nga pejsazhi i natyrës dhe mjedise të ndryshme. ☞ Piktura dhe fotografi që nxisin imagjinatën e nxënësve. ☞ Tekste me personazhe fantastike me fuqi mbinatyrore ose të jashtëzakonshme, si: supermeni, ufo, kuçedra, shtriga, Pinoku, Batman, dinozaurët etj. ☞ Pjesë që lejojnë hapësira për tituj dhe mbyllje të tjera. 	<ul style="list-style-type: none"> • Të përshkruajë shokë, miq, të afërm, objekte, sende e kafshë të njohura e të dashura për të. • Të përshkruajë me fjalët e tij si e kupton një pikturë, një pamje, poster apo një fotografi. • Të shkruajë histori imagjinuese rreth bëmave të personazheve fantastike, si: supermeni, ufo, kuçedra, shtriga, Hirushja, Pinoku, Batman, dinozauri, Tomi e Xherri, Shreku etj. • Të shkruajë mbyllje të tjera të një historie. • Të shkruajë tregime të shkurtra, orientuar nga figura, modele dhe fjalë kyçe. • Të luajë në rol një personazh pozitiv ose negativ. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Përshkrim i shkurtër dhe me ndjenjë i njerëzve të njohur, i sendeve dhe objekteve vetjake, i kafshëve të dashura. ▪ Përshkrim i hollësishëm i një pikturë, poster, fotografie, duke vënë në punë imagjinatën. ▪ Krijim historish me personazhe, që ndikojnë për mirë ose për keq në jetën e fëmijëve. ▪ Krijime të thjeshta sipas imagjinatës. ▪ Lojë në role të personazhit që i pëlqen më shumë.

4. Njohuri rreth gjuhës	☞ Pjesë dhe tekste që i familjarizojnë nxënësit me terma të tilla, si: udhëzim, njoftim, letër, porosi, kartolinë, personazh fantastik, histori, krijim, titull, mbyllje etj.	<ul style="list-style-type: none"> • Të përdorë fjalët dhe termat e duhur në një udhëzim, urim, kartolinë, letër, krijim etj. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Përzgjedhje e saktë e fjalëve specifike gjatë shkrimit të një udhëzimi, urimi, kartoline, letre, krijimi etj.
-------------------------	---	--	---

LINJA: NJOHURI RRETH GJUHËS (82 ORË)

Nënlinja	Tematika	Objektivat	Arritjet e pritshme
<p>SINTAKSË (24 orë)</p>	<ul style="list-style-type: none"> ☞ Teksti dhe fjalia ☞ Fjalia ☞ Zhvendosja e fjalëve brenda fjalisë ☞ Zgjerimi dhe zvogëlimi i fjalisë pa e prishur kuptimin e saj. ☞ Fjalia e vogël ☞ Llojet e fjalisë: dëftore pyetëse, pohore, mohore. ☞ Fjalët kryesore ☞ Fjalët plotësuese 	<ul style="list-style-type: none"> • Të njohë ç'është teksti. • Të dallojë paragrafët dhe fjalitë në një tekst. • Të renditë fjalitë në një tekst të shkurtër. • Të njihet me strukturën e fjalisë. • Të zhvendosë fjalët në një fjali, në mënyrë të tillë që të mos prishet kuptimi i saj. • Të shtojë dhe të heqë fjalë në një fjali të thjeshtë pa prishur kuptimin e saj. • Të gjejë saktë fjalinë më të vogël. • Të njohë fjalinë dëftore dhe pyetëse. • Të njohë fjalinë pohore dhe mohore. • Të njohë e të dallojë fjalët kryesore dhe plotësuese në fjali. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dallim i paragrafëve dhe i fjalive në një tekst. ▪ Ndërtim fjalie duke respektuar strukturën e saj ▪ Zhvendos fjalët në një fjali të thjeshtë pa e prishur kuptimin e saj. ▪ Zgjerim dhe zvogëlim fjalish pa ndryshuar e prishur kuptimin e saj. ▪ Dallimi i fjalisë dëftore dhe pyetëse. ▪ Dallimi i fjalisë pohore dhe mohore. ▪ Dallimi i fjalëve kryesore në fjali me ndihmën e pyetjeve <i>Kush? Cili? Çfarë bën ...?</i> ▪ Dallimi i fjalëve plotësuese në fjali me ndihmën e pyetjeve <i>Kë? Cilin? Kujt?</i>
<p>MOREFOLOGJI (32 orë)</p>	<ul style="list-style-type: none"> ☞ Emri: - Njerëz, sende, kafshë - Gjinia femërore dhe mashkullore - Numri njëjës dhe shumës 	<ul style="list-style-type: none"> • Të njohë fjalë që tregojnë emra njerëzish, sendesh dhe kafshësh. • Të dallojë emrat e gjinisë femërore nga ata mashkullore nisur nga mbaresat e tyre. • Të dallojë emrin në numrin njëjës dhe në numrin shumës. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Njohje e emrave specifikë që tregojnë njerëz, sende dhe kafshë. ▪ Dallimi i emrave të gjinisë femërore dhe mashkullore. ▪ Dallimi i emrit në numrin njëjës dhe shumës.

	<p>☞ Folja:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Koncepti i kohës: dje – sot - nesër - Zgjedhimi i foljeve që mbarojnë me -j - Foljet kam, jam <p>☞ Mbiemri:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Gjinia femërore e mashkullore - Numri njëjës e shumës <p>☞ Përemri vetor</p> <p>☞ Numërori 1-20</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Të njihet me fjalët që tregojnë veprim. • Të dallojë kohën e kryerjes së një veprimi, nisur nga koncepti: dje-sot-nesër. • Të zgjedhë foljet e rregullta që mbarojnë me –j në kohën e tashme e të ardhme. • Të zgjedhë foljet kam, jam në kohën e tashme dhe të ardhme. • Ta dallojë mbiemrin si fjalë që tregon cilësi të emrit. • Të dallojë mbiemrin e nyjshëm të gjinisë femërore dhe mashkullore, nisur nga nyja e përparme. • Të dallojë kur mbiemri është në numrin njëjës dhe shumës, nisur nga ndryshimi i nyjes së përparme. • Të njohë përemrat vetorë: unë, ti, ai (ajo), ne, ju, ata (ato). • Të shkruajë me fjalë numërorët 1-20. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dallimi i fjalëve që tregojnë veprim. ▪ Dallim i kohës së shkuar, të tashme dhe të ardhme të foljes, orientuar nga koncepti: dje-sot-nesër. ▪ Zgjedhim i foljeve të rregullta që mbarojnë me –j në kohën e tashme e të ardhme. ▪ Zgjedhim i foljeve kam, jam në kohën e tashme dhe të ardhme. ▪ Gjetje e fjalëve që tregojnë cilësi të njerëzve, sendeve dhe kafshëve. ▪ Dallim i gjinisë femërore e mashkullore të mbiemrit të nyjshëm, nisur nga nyja e përparme. ▪ Dallim i numrit njëjës dhe shumës të mbiemrit, nisur nga ndryshimi që pëson nyja e përparme. ▪ Renditje e përemrave vetorë sipas radhës së duhur. ▪ Shkrim i numërorëve me fjalë 1-20.
--	--	---	--

<p>LEKSIKOLOGJI (6 orë)</p>	<ul style="list-style-type: none"> ☞ Fjalët e thjeshta dhe të përbëra ☞ Fjalët sinonimike dhe antonimike 	<ul style="list-style-type: none"> • Të njohë e të dallojë fjalë të thjeshta nga fjalët e përbëra. • Të krijojë fjalë të përbëra. • Të gjejë fjalë sinonimike me fjalët e dhëna. • Të gjejë fjalë antonimike të fjalëve të dhëna. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dallim i fjalëve të thjeshta nga fjalët e përbëra. ▪ Krijim i fjalëve të përbëra. ▪ Gjetje deri në 2 e fjalëve sinonimike me fjalët e dhëna. ▪ Gjetje deri në 2 e fjalëve antonimike me fjalët e dhëna.
--	--	---	--

<p style="text-align: center;">DREJTSHKRIM PIKËSIM (20 orë)</p>	<ul style="list-style-type: none"> ☞ Fjalët dy dhe trirrokëshe ☞ Shkronja e madhe ☞ Përdorimi i pikës ☞ Ndarja e fjalëve në fund të rreshtit ☞ Fjalët që përmbajnë grupet e bashkëtingëlloreve: mb, ng, nd ☞ Foljet që mbarojnë me -j ☞ Foljet <i>pi, di, lë, zë</i> ☞ Foljet kam jam ☞ Emrat që mbarojnë me -ar, -or ☞ Emrat e gjinisë femërore që mbarojnë me -ë. ☞ Mbiemrat që mbarojnë me -ë ☞ Mbiemrat që fillojnë me pa- ☞ Numërorët 1-10 dhe 11-20 ☞ Dikttime e ushtrime gjuhësore (6-8) 	<ul style="list-style-type: none"> • Të shkruajë saktë fjalë me dy dhe tre rrokje. • Të përdorë saktë shkronjën e madhe. • Të vendosë në fund të fjalisë pikën. • Të ndajë fjalët në fund të rreshtit në një mënyrë. • Të shkruajë drejt fjalët me grupet e bashkëtingëlloreve mb, ng, nd. • Të shkruajë drejt foljet që mbarojnë me -j. • Të shkruajë drejt foljet e tipit: pi, di, lë, zë. • Të shkruajë drejt emrat që mbarojnë me -ar, -or. • Të shkruajë drejt emrat e gjinisë femërore që mbarojnë me -ë. • Të shkruajë drejt mbiemrat që mbarojnë me -ë. • Të shkruhen drejt mbiemrat që fillojnë me pa-. • -Të shkruhen drejt numërorët nga 1-10 dhe nga 11-20. • Të shkruajë bukur e pa gabime drejtshkrimore tekste të shkurtra me të kopjuar dhe me diktim. 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Shkrimi drejt i fjalëve dy dhe trerrokëshe. ▪ Përdorim i saktë i shkronjës së madhe në fillim të fjalisë dhe te emrat e përveçëm. ▪ Vendosje në fund të fjalisë të pikës. ▪ Ndarje e saktë e fjalëve në një mënyrë në fund të rreshtit. ▪ Shkrim drejt i fjalëve që përmbajnë grupet e bashkëtingëlloreve mb,ng, nd në trup të tyre. ▪ Shkrim drejt i foljeve që mbarojnë me -j. ▪ Shkrim drejt i foljeve të tipit: <i>pi, di, lë, zë</i>. ▪ Shkrim drejt i emrave që mbarojnë me -ar, -or. ▪ Shkrim drejt i emrave të gjinisë femërore që mbarojnë me -ë. ▪ Shkrim drejt i mbiemrave që mbarojnë me -ë. ▪ Shkrim drejt i mbiemravet që fillojnë me pa-. ▪ Shkrim drejt i numërorëve nga 1-20. ▪ Shkrim bukur e pa gabime drejtshkrimore i teksteve të shkurtra me të kopjuar dhe me diktim.
--	---	---	--

Parime të sotme për mësimin e gjuhës shqipe

A. PARIME TË PËRGJITHSHME

Mësimi i gjuhës shqipe (amtare) në arsimin fillor:

- të ruajë dhe të respektojë karakterin e vet kombëtar.
- të ruajë nga tradita elementet më përparimtare, duke i bashkuar ato edhe me elemente dhe komponentë të rinj kurrikularë.
- të reflektojë identitetin kulturor duke e krahasuar edhe me kulturat e vendeve fqinje.
- të kontribuojë në formimin e përgjithshëm intelektual të çdo nxënësi.
- të kontribuojë në krijimin e marrëdhënieve humane ndërmjet njerëzve.
- të reflektojë dimensionet e sotme të zhvillimit të shoqërisë njerëzore.

B. PARIME SHKENCORE

Mësimi i gjuhës shqipe (amtare) në arsimin fillor:

- të lidhet ngushtësisht me të gjitha shprehjet komunikative.
- të mbështetet në modelet më të mira *të fjalës së dëgjuar, të folur, të lexuar e të shkruar*, të gjuhës që zhvillohet në procesin e vet të gjallë.
- të përcjellë zhvillimet e reja të gjuhës dhe të ligjeve të zhvillimit të saj të brendshëm e të jashtëm.
- të jetë në qendër të çdo lënde shkollore dhe të vlerësohet si një proces, objektivat e të cilit, janë detyrim për çdo lëndë shkollore.

C. PARIME DIDAKTIKE

Mësimi i gjuhës shqipe (amtare) në arsimin fillor:

- të përfshijë në përmbajtjen e vet elemente të zhvillimeve të sotme të didaktikës bashkëkohore.
- të mbështetet në natyrën intuitive të fëmijëve për trajtimin e dukurive gjuhësore.
- të ketë karakter të theksuar praktik.
- të ketë në qendër zhvillimin dhe përdorimin e metodave dhe strategjive të reja të didaktikës bashkëkohore.
- ta kthejë mësimdhënien me në qendër fëmijën.
- të zhvillohet përmes përdorimit të materialeve autentike (të riciklueshme), përfshirë këtu materiale të medias së shkruar dhe të folur, televizorit, radios, kompjuterit etj.
- të zhvillohet në mënyrë të tillë, që ta shohë nxënësin në qendër të procesit mësimor dhe t'i lejojë atij të drejta të plota për t'u marrë me përvojat jetësore që ai zotëron.

Ç. PARIME SPECIFIKE TË ORGANIZIMIT TË STRUKTURËS DHE PËRMBAJTJES SË LËNDËS

Ndër parimet që veprojnë në organizimin strukturor dhe përmbajtësor të lëndës së gjuhës shqipe veçojmë:

- Parimin linear
- Parimin koncentrik dhe
- Parimin e integritit (brenda lëndës dhe ndërlëndor).

Krahas respektimit të parimit linear kërkohet që mësimi i gjuhës shqipe të përshkohet nga respektimi i parimit të integritit brenda dhe ndërlëndor, si një parim i cili ndikon dukshëm në përmirësimin e cilësisë së të nxënit.

Duke e parë integrimin si një parim të rëndësishëm, i cili do të përbëjë një ndër ndryshimet themelore të organizimin dhe hartimin e teksteve shkollore të gjuhës shqipe, të orientuara nga ky program, paraqesim më poshtë disa përparësi dhe mënyra të integritit brenda dhe ndërlëndor.

INTEGRIMI

Përparësitë:

- Ndikon në përmirësimin e cilësisë së arsimit.
- Ndikon në përmirësimin e përmbajtjeve të fushave kurrikulare.
- Ndikon në respektimin e synimeve globale të edukimit.
- Ndikon në përmirësimin e procesit të mësimdhënies dhe të nxënit.
- Krijon mundësi të shumta për bashkëveprim.
- Krijon mundësi të shumta për respektimin e koherencës dhe të ballancës në kurrikul.

Llojet e integritit:

Pranohen llojet e mëposhtme të integritit:

- Integrim *midis lëndëve*;
- Integrim *midis fushave të studimit* (linjave dhe nënlinjave);
- Integrim *në planin e bashkëveprimit të objektivave*;
- Integrim *në përdorimin e metodave ndërvepruese në mësimdhënie*;
- Integrim *përmes zbërthimit të përmbajtjes lëndore përmes fushave të veprimtarisë së individit (Të mësuarit me tema)*;
- Integrim *përmes zbërthimit të objektivave themelore si lëndë në objektiva specifike*;
- Artet, drama, historia, kultura janë fusha të sukseshme me të cilat mund të integrohet mësimi i gjuhës shqipe në shkollën fillore.
- Mësimi tematik është një kriter tjetër që mundëson integrimin dhe që integron shumë fusha të dijes.

TË MËSUARIT ME TEMA

Nëpërmjet të mësuarit me tema nxënësi nxitet të hulumtojnë:

- *Në marrëdhënie të caktuara shoqërore* të fushave të tilla, si: familja, shkolla, shoqëria, loja, mësimi, tregtia, detaria, paqja, miqësia etj.
- *Në identitetin e tyre kulturor*, nëpërmjet të cilit ata mund të njohin të djeshmen, të sotmen, traditën, historinë, folklorin e shumë aspekte të tjera të jetës shqiptare.
- *Në njohjen e mjedisit fizik të gjuhës*, dialektin, gjuhën qytetëse si dhe gjuhën standarde shqipe. Nxënësve u jepet mundësi për të kërkuar dhe hulumtuar në burimet dhe rrugët e mundshme që ndikojnë në pasurimin e gjuhës.
- *Në marrëdhëniet shoqërore* përmes të cilave synohet të studiohen dhe të përvetësohen përmes përvojave individuale të sejcilit nxënës, përvoja të tilla nga jeta familjare, kariera profesionale, politike, shkencore, struktura të ndryshme sociale, morali i shoqërisë etj.

METODAT E MËSIMDHËNIES

Programi “Gjuha shqipe 2” është një program i cili kërkon njohjen dhe përdorimin e metodave ndërvepruese të mësimdhënies, të cilat kanë në qendër të mësimdhënies dhe të nxënies nxënësin.

Rekomandohen të përdoren metodat projektit të zhvillimit të mendimit kritik, metoda të punës të programit “Hap pas hapi”, të projektit “Danida”, të të mësuarit me tema etj.

Për njohjen e metodave ndërvepruese materiale të botuara nga ISP dhe të tjera të botuara nga shoqata që punojnë në dobi të arsimit, që i drejtohen kësaj moshe do të mundësojnë përgatitjen e mësuesve për të krijuar një profil të ri mësimdhënieje në përshtatje me kurrikulat e reja.

VLERËSIMI

Vlerësimi është një fushë e rëndësishme në procesin mësimor-edukativ. Ai ka të bëjë me mënyrat dhe teknikat që përdoren për përparimin e nxënësve për tema të veçanta, për grup temash ose për përfundimet e tyre mësimore në mbyllje të semestrit e të vitit shkollor.

Vlerësimi i nxënësve në lëndën e gjuhës shqipe ka për qëllim:

- të sigurojë informacione identifikuese për arritjet e tyre,
- të përcaktojë përparimin e nxënësve,
- të sigurojë realizimin e objektivave të përcaktuara,
- t'i motivojë nxënësit.

Për klasën e dytë, udhëzohen kryesisht këta tipe vlerësimi:

- Vlerësim me fjalë dhe me shprehje, me gojë dhe me shkrim për shënime në regjistër.
- Vlerësim me lista dhe dosje personale.
- Teste për grupe temash, në fund semestri dhe në fund të vitit.